



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET

EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

Procesi i integritit të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes sociale.

Dr. Silvana Dode

Chair Jean Monnet – EEAABAC
Departamenti i së Drejtës – UNIEL

Jean-Monett- biznesmen francez se bashku me Robert Schuman, ministri i jashtem francez.

Pikerisht Monet propozoi krijimin e nje institucioni te pavarur me tipare mbi-kombetare dhe jo thjesht nderqeveritare.

Jean Monett ka qene presidenti i pare i Komunitetit Europian te Qymyrit dhe Celikut.

Harmonizimi progresiv i politikave sociale u sugjerua qe ne vitin 1955, pas krijimit te Komunitetit Europian te Qymyrit dhe Celikut. **Prej marsit 1957 kur u miratuan dy Traktatet e Romes, u sugjerua krijimi i “Fondit Social Europian”**. Ky fond synon financimin e drejtperdrejt nga Bashkimi Europian te shteteve anetare, dhe synon disa qellime:

a.Promovimi i grave ne tregun e punes dhe zhvillimi i politikave te barazise gjinore.

b.Nje pleqeri aktive dhe e shendetshme

c.Perfshirje sociale e shtresave te marxhinalizuara.

d.Rritje e punesimit dhe profesionalizimit permes trajnimeve te te punesuarve (politika “life-long learning.”)

e.Promovim i edukimit dhe te evitohet largimi i parakohshem nga puna.

▪Traktati i Mastrihtit i vitit 1993 krijoi skemen me 3 shtylla te BE.

Shtetesia Europiane, Kujdesi shendetesor, Politikat Sociale dhe politikat e azilit jane te perfshira ne shtyllen e pare.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

❖ **Komisioni European e ve theksin se integrimi nuk duhet konsideruar si nje ceshtje thjesht teknike** *“Joining the EU is far more than a technical process. It is a generational choice, based on fundamental values, which each country must embrace more actively, from their foreign and regional policies right down to what children are taught at school.”*
Ceshtjet e politikave sociale konsiderohet nje ceshtje me shume rendesi ne vitet e ardhshme ne kuader te BE.

❖ Ne nje nga Deklaratat qe Komisioni European i ka drguar ne vitin 2019 Parlamentit European dhe Komitetit European Politik dhe Social deklaroi:

*“Increase focus on **employment and social reforms** through greater monitoring of relevant policies and establishment of an annual EU-Western Balkans Ministerial meeting on these issues, that will feed into the economic reform programmes.”*

❖ Po ashtu, Komisioni European deklaroi se lidhur me perspektiven e zgjerimit te Ballkanit Perendimor, qellimi i BE do jete qe *“Provide more financial assistance in the **social field** in the Western Balkans including on health.”*

Qo ashtu, Komisioni European shpreht se *“All the Western Balkan countries must now urgently redouble their efforts, address vital reforms and complete their political, economic and social transformation, bringing all stakeholders on board from across the political spectrum and from civil society. “*

Ceshtjet e politikave sociale shihen si nje fushe ku nga te gjitha vendet e Ballkanit Perendimor ka ende shume pune per tu bere e per tu permiresuar. *“Much remains to be done across the board to align with the EU's acquis, to establish or build up the related institutions, and to ensure implementation capacity, whether in terms of single market rules, social policy, energy and transport acquis or EU environmental law.*

□Lidhur me politikat sociale, Komisioni European propozon konkretisht dy drejtime kryesore.

1-This will include an increased focus on **employment and social reforms** through greater monitoring of relevant policies, including in the context of the economic reform programmes.

2- The Commission proposes **an annual EU-Western Balkans Ministerial meeting on social and employment issues to exchange views**



Strategjia e zgjerimit të BE ndërkohë dhe si të investimi dhe reformimi i të drejtave sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor.

1- ERSP

Dialogue on employment and social reform programmes - detyrë e Komisionit Evropian.

2- WBIF

2014 “The Western Balkans Investment Framework (WBIF)

Në bazë të programit WBIF, Komisioni Evropian, dhurues bilaterale dhe institucione financiare ndërkombëtare investojnë 4 miliardë euro investime në vit në fushën e transportit, energjisë, mjedisit, ndryshimet klimatike, duke përfshirë një ekonomi efektive dhe fushën e sektorit social.

3- Fondi Social

Por çfarë është Fondi Social dhe çfarë ka përfituar konkretisht Shqipëria nga ky fond?

Në bazë të Nenit 153 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE), Unioni mbështet dhe plotëson aktivitetet e vendeve anëtare në fushën e politikave sociale. Fondi Social Evropian është mjeti kryesor financiar përmes të cilit BE mbështet zbatimin e strategjisë së saj të punësimit dhe kontribuon në përpjekjet e përfshirjes sociale



❖ Politikat Sociale dhe të Punësimit perfshihen në kapitullin 19 të MSA.

Në këto fushë, qëllimi kryesor që BE ka lidhur me ndryshimet ligjore të Shqipërisë janë si më poshtë:

- a. Rritje e punësimit.
- b. Permiresim i kushteve të punës dhe jetesës.
- c. Krijimi i mekanizmave të mbrojtjes sociale sipas standarteve të duhura.
- d. Të promovohet dialogu mes partnereve sociale
- e. Të zhvillohen burimet njerezore me qëllim që të sigurohet një punësim i qëndrueshëm
- f. Të luftohet varferia dhe perjashtimi social.
- g. Të ofrohen mundësi të barabarta për meshkujt dhe femrat

❖ MSA dhe politika sociale në këto marrëveshje

a. Neni 99 “Bashkëpunimi social”

“Palët bashkëpunojnë për të lehtësuar reformat e politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit. Bashkëpunimi synon të mbështesë përshtatjen e sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale, dhe përfshin përshtatjen e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë, ashtu si dhe përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë për punëtorët, duke ju referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në Komunitet. “

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

MSA- Politikat Sociale në këte marrëveshje

b.Neni 48 i MSA

1. Do të vendosen rregulla për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty.

2-Të gjitha periudhat e sigurimeve, punësimit apo qëndrimit të përfunduar nga punonjësit të tillë në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të mbledhen bashkë për qëllimin e dhënies së pensioneve dhe pagave vjetore në lidhje me pleqërinë, paaftësinë fizike dhe vdekjen dhe për qëllim përkuqdesjeje shëndetësore për këtë kategori punonjësish dhe familjarët e tyre;

3- Pensionet ose pagesat vjetore në lidhje me pleqërinë, vdekjen, aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale, ose invaliditeti që shaktohet nga puna, me përjashtim të përfitimeve jo-kontribuuese, transferohen pa pengesë në masën e aplikuar sipas legjislacionit të Shtetit ose Shteteve Anëtare debitor;



Sofia Declaration 2018

“We, the leaders of the European Union (EU) and of its Member States, in consultation with our Western Balkans partners, and in the presence of relevant regional stakeholders, today concluded the following:

*1. The EU welcomes the shared commitment of the Western Balkans partners to **European values and principles**, and to the vision of a strong, stable and united Europe, underpinned by our historic, cultural and geographic ties and by our mutual political, security and economic interests.*

*2-The EU is determined to strengthen and intensify its engagement at all levels to support the region's political, economic and social transformation, including through increased assistance based on tangible progress in the rule of law, **as well as in socio-economic reforms, by the Western Balkans partners.***

*3-Constructing a dense web of connections and opportunities within the region and with the EU is vital for bringing our citizens and economies closer together, and for enhancing political stability, economic prosperity, cultural and social development. **Building on progress made, including through regional initiatives, we pledge to enhance substantially connectivity in all its dimensions***

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES





Procesi i integritit te Shqiperise ne fushen e mbrojtjes sociale

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Fazat ku do kaloje procesi i integritit

1-Nenshkrimi i MSA –qershor 2006

2-Hyrja ne fuqi e MSA –prill 2009

3- Shqiperia ka marre statusin e vendit kandidat per ne BE ne qershor 2014.Dhenia e statusit te vendit kandidat u be pasi Shqiperia miratoi nje program te detajuar te reformave kyce qe ajo do kryente duke iu referuar prioriteteve te kerkuara nga BE

4-Më 25 mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur në reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në unanimitet nga Keshilli i qershorit 2018.

5- Më 26 mars 2020, Këshilli Evropian miratoi vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së për hapjen e negociatave me Shqipërinë

Kriteret e Kopenhagenit

Keto jane kriteret qe duhet te plotesoje nje shtet per tu bere anetar i Bashkimit European.Keto kriteret u shpallen ne Samitin e Kopenhagenit ne vitin 1993.

Keto kriteret kerkojne qe te perfshihet legjislacioni i Bashkimit European ne korpusin ligjor te Shqiperise dhe te zbatohet ky legjislacion.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



Ndryshimet e fundit ligjore në fushën e Mbrojtjes Sociale në Shqipëri

- **1-Ligji për strehimin social (2018)**

-Miratimi i këtij ligji u theksua edhe nga Komisioni Europian në Komunikatën e tij të vitit 2019

“Legal framework was improved in the areas of child’s rights and domestic violence. A new law on social housing was approved by the parliament in May 2018, which aims to strengthen the protection of the right to housing of the most vulnerable members of the Roma and Egyptian communities.”

-Edhe në Progres Raportet e Komisionit Europian për Shqipëri theksohet se

“the budget allocated for (social) housing programmes is limited and does not provide for all proposed actions to be carried out.”

-Programet konkrete që ky ligj njih janë ‘

Programin e banesave sociale me qira, në vijim BSQ;

Programin për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;

Programin e banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;

Programin për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;

Programin për krijimin e banesave të përkohshme;

Programin e banesave të specializuara.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



1-Ligji për strehimin social (2018)

Problemet e këtij ligji

- a. Shpesh ka vështirësi në plotësimin e dokumentacionit nga palët e interesuara.
- b. Njihet *parimin e sigurisë së qëndrimit (neni 5)*, duke ndaluar dëbimin në çdo rast dhe duke ofruar garanci për individët/familjet që preken nga procesi i zhvendosjes.
- c. **Parashikon krijimin e Fondit Publik të banesave sociale**
Fondi i banesave sociale përfshin tërësinë e banesave, të krijuar nga organet e vetëqeverisjes vendore dhe/ose qendrore, subjektet private fitimprurëse ose jofitimprurëse, financimet nga taksat e ndikimit në infrastrukturë si dhe donacione e burime të tjera të ligjshme
- d. Në ligjin e ri, është parashikuar **një program i ri për ‘Pronarin Social’**, që u mundëson ndërtuesve që nuk kanë shitur apartamentet e tyre, të përfitojnë statusin pronar social dhe t’i japin me qira sociale për familjet aplikuese për strehim”,



e. Ne disa raste ka pasur zbatim të gabuar të ligjit dhe akte nenligjore kontradiktore “, [në nenin 14 të ligjit për Strehimin Social](#), ku përcaktohen rregullat e përgjithshme për aplikimin në programet sociale të strehimit, në pikën 2 deklarohej “*Individi/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë*”. Ndërsa në udhëzimin e Bashkisë së Tiranës, që është një akt nënligjor i ligjit të ri për Strehimin Social, deklarohej se të gjitha dokumentet duhet t’i sigurojë aplikuesi, duke rënë në kundërshtim me atë që citon ligji

f. Programi i banesave të specializuara është aktiv vetëm në Durrës (nevoja për zbatimin e tij në gjithë territorin e shtetit.)

g. Te kete nje “një strategji efektive me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin duke evidentuar mjete dhe metoda efektive dhe të diversifikuara.”

2-Ligji “Per sherbimet e kujdesit shoqeror” (2016) dhe Ligji “Per Asistencen Sociale” (2019)

Permes ketyre ligjeve . kemi ndarjen ne 2 ligje te vecanta, te cilat kryejne nje rregullim te detajuar. Para vitit 2019, keto fusha ishin te rregulluara ne nje ligj te vetem , ne ligjin e vitit 2005.

Ligji i ri “Per asistencen sociale” e ka shnderruar skemen e Ndhimes Ekonomike ne nje skeme aktive, e cila mundeson disa elemente:

a.ri-integrimin shoqëror; b rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjen dhe sigurimin e ri-integritetit të fëmijëve në familje dhe në komunitet, duke siguruar kujdes të veçantë për jetimët social dhe biologjik, dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare

Skema e Ndhimes ekonomike do funksionojë me mire permes “forcimit te lidhjeve midis politikave aktive të tregut të punës dhe skemës së ndihmës sociale.”

3- Ligji “Per nxitjen e Punesimit” 2019

4- Ligji “Per fondet e pensionit vullnetar” (2009)

Aktualisht eshte hartuar dhe synohet miratimi i nje ligji te ri lidhur me pensionet private. Duhet perditesim i legjislacionit lidhur me semundjet profesionale dhe sigurine ne pune.

5-Ligji “Siguria ne pune” (2010)

VKM “ Per semundjet profesionale” (2015)

VKM “Aksidenti ne pune” (2005)

6- Ligji i vitit 2011 “Për sigurimet shëndetësore”

Ky ligj , sic pohohet në PKIE i vitit 2014-2020 “Qëllimi i ligjit është të vendosë skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, parimet dhe procedurat e funksionimit të saj, si dhe menaxhimin e saj nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. E një rëndësie të veçantë është hapi i ndërmarrë në këtë ligj për shndërrimin e ISKSH-së në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësorë. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një ndryshim të emrit, por me krijimin e një Fondi që do të sigurojë fleksibilitet në financimin e shërbimeve shëndetësore, transparencë në administrim dhe besueshmëri maksimale të të sigurveçarit që kanë derdhur kontribute pranë tij.”

Ne skemen aktuale të sigurimeve shëndetësore, burimet e financimit të kujdesit shëndetësor përbëhen kryesisht nga kontributet e të punësuarve dhe të punëdhënësve si dhe nga taksat e tatimet (buxheti i shtetit). **Ligji thekson gjithashtu se i gjithë sistemi i kujdesit shëndetësor bazohet mbi parimin e solidaritetit dhe për këtë shkak, ai ka siguruar mbulim me sigurim për personat ekonomikisht aktivë dhe ata jo aktivë, ku futen personat që trajtohen nga sigurimet shoqërore dhe ndihma sociale, punëkërkuesit, fëmijët deri 18 vjeç, si dhe nxënësit e studentët deri 25 vjeç**

Strategjite Kombetare ne Shqiperi dhe ne Planin Kombetar te Integritit PKIE 2022-2024)

□ Se pari objektivat e Shqiperise lidhur me politikat sociale jane

- a. Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;
- b. Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale 2015 – 2020, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;

□ Se dyti, lidhur me politikat e Mbrojtjes Sociale dhe te barazise gjinore

- a. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale për 2020 – 2023 dhe Planit të saj të Veprimit;
- b. Zbatimi i “strategjisë së daljes” që mundëson ri-integrimin shoqëror të përfituesve të NE;
- c. Shtrirja graduale e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;
- d. Zbatimi i Planit Kombëtar të de-institucionalizmit 2020 – 2022 që synon zëvendësimin e qendrave rezidenciale me shërbimet të kujdesit social alternative komunitare;
- e. Vendosja e lidhjeve dhe integrimi më i mirë ndërmjet politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale dhe politikave të mbrojtjes sociale.
- e. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030;
- f. Fuqizimi i mëtejshëm së makinerisë së posaçme gjinore kombëtare dhe sigurimi i financimit të duhur.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

Se treti, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve

Funksionimi i një sistemi mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve. Forcimi i kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve. Përmirësimi i mekanizmave dhe shërbimeve specifike dhe të integruara për të trajtuar format më të rënda të dhunës, duke përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin në internet.

Se katërti, lidhur me skemen e sigurimeve shoqërore

- a. Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme;
- b. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës dhe zhvillimi i kapaciteteve të ISSH-së, implementimi gradual i projekteve të nisura për ngritjen e një sistemi kompleks e të automatizuar informacioni për plotësimin e funksioneve të sigurimeve shoqërore edhe për të tretët;
- c. Mbështetje e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit, përmes koordinimit të skemave të mbrojtjes sociale me vendet e BE-së edhe më tej duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.



Se pesti, lidhur me përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara

- a. Harmonizimi i të dhënave për përfshirjen sociale për grupet në nevojë;
- b. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2021 – 2025 për Personat me Aftësi të Kufizuara;
- c. Përmirësimin i bazës ligjore sipas parimeve të Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara

Se gjashti, lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë

Objektivi kryesor mbetet zbatimi i politikave dhe ligjeve më të mira dhe më të dobishme për SSHP, të cilat mund të zbatohen në një mënyrë të dobishme duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të SSHP.

Në fushën e legjislacionit të punës prioritetet do të jetë përmirësimi i zbatimit të tij në sektorin publik dhe atë privat.



Se shtati, në lidhje me zhvillimin e dialogut social ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve, objekti kryesor mbetet promovimi i avantazheve të zgjidhjes paragjyqësore të konflikteve në punë; aftësimi i punëmarrësve dhe punëdhënësve për negociim dhe parandalim të mosmarrëveshjeve në punë; përmirësim i efektivitetit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe pajtimit të mosmarrëveshjeve kolektive në punë.

Por praktikisht zhvillimi i dialogut social mbetet i ulët, ashtu siç theksohet në “ Progres raportin e Shqipërisë të vitit 2020

“Dialogu social dypalësh mbetet i dobët si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik, kryesisht për shkak të përvojës së pamjaftueshme të sindikatave, mungesës së kulturës së dialogut, si dhe skepticizmit të punëdhënësve ndaj sindikatave.”

Ne vitin 2021 u miratua Konventa e ONP Numer 190 mbi “Violence and Harassment in the World of Work”.

Progres Raporti thekson *“It is important that the government undertake concrete measures and revise the legislation in alignment with the ILO convention.”*



Fushat ku duhet nderhyrje

1- Minimumi jetik.

Parimi që ONP dhe Bashkimi Europian theksojnë “te ardhurat baze që sistemi i mbrojtjes sociale në teresi ofron, duhet të mundesoje një jetë dinjitoze.”

Cilet elemente duhen pasur në konsideratë kur caktohet minimumi jetik

- a. Vlera monetare e grupeve të mallrave të shërbimeve me të nevojshme
- b. Pragu kombëtar i varferisë
- c. Kufijtë e të ardhurave për asistencë sociale

-Minimumi jetik është një teresi të ardhurash që synojnë të plotësojnë nevojat bazike të qytetarëve. Minimumi jetik për një person është **20.000 leke të reja në muaj** (kjo sipas studimit të Avokatit të Popullit në vitin 2022, sipas linkut bashkëngjitur materialit.

-Percaktimi i minimumit jetik është i domosdoshëm. Nëse ky minimum do caktohet me ligj, do ketë :

a. Përfutjes të drejtperdrejte, që janë familjet me ndihmë ekonomike, pensionistet, të papunet, punetoret me page minimale dhe kategoritë në nevojë.

b. Përfutjes indirekt në rast percaktimi të minimumit jetik do të ishin pjesa më e madhe e popullsisë, pasi në rast caktimi të minimumit jetik pagat dhe pensionet e tyre do rriteshin si pasoje e drejtperdrejte zinxhir e rritjes së të ardhurave të shtresave të varfra.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES





B-Pensionet private

PKIE i vitit 2014-2020 ishte i pari që propozoi ndryshime në ligjin lidhur me pensionet private.

“Nevojiten përpjekje shtesë për përafrimin e legjislacionit me *acquis* në fushat e sigurimit dhe pensioneve profesionale.”

Aktualisht është në fuqi Ligji i vitit 2009 “Per fondet e pensionit vullnetar”.

Varianti i projektligjit, që është nxjerre në konsultim publik, sjell disa risi. Ky projektligj është pershtatur me Direktivën e Bashkimit Europian, IORP II.

Risite e këtij Projektligji janë:

I-Një kategorizim të ri të fondeve të pensionit,

Në projektligj fondet ndahen në fonde me pjesëmarrje të hapura dhe fonde me pjesëmarrje të mbyllur. Fondet me pjesëmarrje të mbyllur do të krijohen vetëm për punëmarrësit e subjekteve që mund të jenë disa punëdhënës ose një entitet i organizuar si bashkim punëdhënësish, sindikatë apo bashkim sindikatash. Fondi me pjesëmarrje të mbyllura do i dedikohet vetëm këtyre subjekteve dhe nuk do të akomodojë në këtë fond subjekte të tjera. Projektligji të gjitha këto subjekte i përcakton si “sponsor”, kjo në përputhje dhe me direktivën e Bashkimit Evropian.

Ndërsa fondet me pjesëmarrje të hapur do t’u ofrohen të gjithë anëtarëve që nuk janë pjesë e një sponsori, siç funksionojnë fondet me ligjin aktual.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



II-Rrit pragun e përjashtimit nga tatimi për të ardhurat personale duke e lidhur atë me pagën minimale,

Përsa i përket përfitimit nga përjashtimi i kontributeve nga tatimi mbi të ardhurat personale nënkupton që punëmarrësi do të mund të paguaj 30,000 lekë në muaj, sa paga minimale aktuale, në një fond pensioni privat dhe ky kontribut të zbritet nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe deklarimet tatimore mujore. Një faktor i rëndësishëm është propozimi që ky përjashtim nga tatimi të jetë sa paga minimale që do të thotë që me rritjen e pagës minimale edhe ky përjashtim nga tatimi do të rritet.

III- Propozon tatimin vetëm për kthimin nga investimi në momentin e tërheqjes së fondeve në formë pensioni

IV- Shton disa kërkesa të reja për shoqëritë administruese që do rezultojë në kosto për implementimin e tyre

Projektligji propozon shtimin e disa kërkesave të reja për transparencën ndaj klientëve, të cilat përmirësojnë mënyrën e paraqitjes dhe gamën e informacioneve për klientët, megjithatë edhe aktualisht shoqëritë administruese ofrojnë një informacion transparent dhe të plotë për anëtarët. Ka mendime se “Këto kërkesa shtesë për transparencën do shtojnë kostot për implementimin e tyre në sistemet informatike të shoqërive administruese duke rënduar mbi gjendjen financiare të këtyre shoqërive.”

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



V- Projektligji parashikon edhe mundësinë për transferimin vullnetar të një fondi pensioni nga një shoqëri administruese të tjetra. Një veprim i tillë duhet të miratohet paraprakisht me AMF. Shoqëria që transferon administrimin e fondit, informon anëtarët e fondit lidhur me transferimin, tre muaj përpara implementimit.

VI- Projektligji i ri lehtëson ndjeshëm masën e sanksioneve dhe penaliteteve të parashikuara ndaj shoqërive administruese dhe administratorëve të tyre. Nëse me ligjin aktual parashikohen gjoba deri në 10 milionë lekë, madje edhe ndjekje penale për personat përgjegjës, projektligji i kufizon gjobat më të rënda deri në vlerën e 3 milionë lekëve.

Lidhur me pensionet private, mendohet se reformat e fundit nuk janë të mjaftueshme. **Konsiderohet e nevojshme forma të tjera për stimulimin e fondeve të pensionit privat**

- a. duke realizuar një kombinim ndërmjet bërjes së detyrueshme të pensioneve private, sidomos për kategori të caktuara punësh, apo profesione të caktuara,
- b. njëkohësisht duke dhënë stimuj monetarë për anëtarët



3- Menxhim me i mire i sistemit të sigurimeve shoqerore.

Kjo behet duke njohur me mire dispozitat ligjore të sigurimeve shoqerore dhe sfidat me të cilat ky sistem perballlet.

Sugjerohet që njohuritë mbi sigurimet shoqerore duhet të jenë pjesë e kurrikulave të arsimit në dege të ndryshme dhe trajnim i vazhdueshëm i punonjesve dhe studenteve në nivele të ndryshme të sistemit kombëtar të edukimit.

4- Sherbimet sociale duhet të kenë një përgjegjësi me të madhe dhe të kenë një sjellje me “proaktive” lidhur me zbulimin e trajtimin e rasteve të femijeve që ndodhen në situatë abuzimi dhe neglizhence nga kujdestaret ligjore.

Sipas GJEDNJ “ Sherbimet sociale, nëse janë në idjenti të rasteve të abuzimit me femijet, kanë detyrim pozitiv të mbrojnë femijet. Nëse kjo nuk arrihet, kemi të bëjmë me deshtim të sistemit për të mbrojtur femijet nga neglizhimi dhe abuzimi serioz dhe afatgjatë.”

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



Procesi i integritit të Shqipërisë në fushën e mbrojtjes sociale

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



5- Planet vendore të Kujdesit Social të miratuar do ndihmojnë me mire në planifikimin dhe zbatimin e politikave në fushën e mbrojtjes sociale.

“Sipas të dhënave të Shërbimeve Sociale, **mbulimi i kujdesit shoqëror është mjaft i ulët, me vetëm rreth 10 000 përdorues në vitin 2019 (0.35% e popullsisë)**. Rritja e investimeve për zhvillimin e shërbimeve të reja të kujdesit social dhe mbulim më i gjerë gjeografike janë urgjentisht të nevojshme. Njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) pritet të vlerësojnë nevojat në territorin e tyre dhe të përgatisin plane vendore të kujdesit social, por atyre u mungojnë burimet njerëzore dhe financiare për të kryer këtë detyrë. Vetëm 24 bashki kanë miratuar planet e kujdesit social.

Ne Progres Raportin e Shqipërisë theksohet

“Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, të miratuar në vitin 2019, specifikojnë që **qeveria qendrore do të duhet të japë fondin social nga buxheti qendror duke alokuar buxhete të tilla në planet e miratuara të kujdesit social vendor**. Në prill 2019, qeveria ngriti mekanizmin e Fondit Social si një masë kalimtare për shpërndarjen e fondeve nga buxheti i shtetit për bashkitë. **Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka filluar ta bëjë funksional fondin social duke dhënë 14 projekte për të mbështetur krijimin e shërbimeve të kujdesit social në nivelin vendor**. Aplikimi është i hapur vetëm për bashkitë të cilat kanë një plan të miratuar dhe të buxhetuar të kujdesit social, duke nënvizuar nevojën për të rritur numrin e bashkive me një plan të miratuar dhe të buxhetuar.”

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES





Procesi i integritit te Shqiperise ne fushen e mbrojtjes sociale

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



6-Ende rritja e nivelit te financimit ne politikat sociale, dhe lidhja mes tregut te punes dhe sherbimeve sociale eshte ceshtje me rendesi.

Progres Raporti i Komisionit European i vitit 2021 per Shqiperine thekson “ *The social care reform is progressing, but financial and administrative efforts need to be stepped up to strengthen the local level capacities for service delivery and the links to active labour market measures.*”

Edhe per vitin 2022 stuata mbetet e njejte. Progres Raporti i Komisionit European deklarone se “ *Public spending on social care services programmes for Albania continues to be modest and there is yet no mechanism for monitoring the situation of those who are vulnerable and with no access to such services.*”

7-Rritje e kualifikimit profesional te punonjesve qe operojne ne fushen e mbrojtjes sociale.

Trajnim i vazhdueshme i tyre. Ne vitin 2021 u miratua baza ligjore per “Dhoma e Punonjesve Sociale”.

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



8- Bashkepunimi mes institucioneve ne nivel vendor.

Progres Raporti 2022 thekson “The Ministry of Health and Social Protection and Ministry of Finance and Economy signed a joint order to establish coordination and a referral mechanism with a view to integrate in the labour market the beneficiaries of the economic aid of active working age. Furthermore, a protocol for integrated case management between employment offices and local social care services is established and started its implementation in Elbasan municipality.”

9- Lidhur me strehimin social duhet te perfshihen tek kategorite qe gezojne mbrojtje te vecante sipas ketij ligji, te gjitha viktimat e dhunes, apo veprave penale, dhe jo vetem ato te dhunes ne familje apo te trafikimit.

Ky fakt po sugjerohet shume se fundmi edhe nga shoqeria civile.

Aktualisht, lidhur me viktimat e veprave penale, ligji “Per strehimin social”, ofron nje mbrojtje specifike per viktimat e dhunes ne familje, per viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme te trafikimit.

10- Ligji për sigurimet shëndetësore

Lidhur me reformimin e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor është domosdoshmëri dhe duhet të konsistojë në **liberalizimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm, e cila konsiston në dhënien e së drejtës së të punësuarve që të përdorin lirisht kontributin e tyre dhe një pjesë të kontributit të punëdhënësit për të zgjedhur dhënësin e shërbimit të kujdesit shëndetësor** nëpërmjet kompanive private të sigurimit. Për shkak të disa rreziqeve që mbart ky proces, liberalizimi i kësaj skeme, fillimisht mund të jetë i kontrolluar nga Qeveria dhe do të kushtëzohet si dysheme me paketën bazë që ofron aktualisht Fondi.

Ka sugjerime se për të ruajtur parimin e solidaritetit, punonjësit mund t'i vihet në dispozicion të transferojë në shoqërinë e sigurimeve që ka zgjedhur, jo të gjithë shumën e destinuar për sigurime shëndetësore (aktualisht paguhet 3.4% e pagës bruto; 1.7% punëmarrësi dhe 1.7% punëdhënësi) por mund të jete një shumë më e vogël 2.9%, dhe pjesa tjetër të transferohet për llogari të menaxhimit të skemës shtetërore.

Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

Bibliografi

- 1- Progres Raportet e Komisionit European per Intgrimin e Shqiperise ne BE,
<https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/63-progres-raportet>
- 2- Raport “Per standartin e Minimumit Jetik ne Shqiperi”, Botim Avokati I Popullit dhe UNDP Albania, 2021,
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>
- 3- VKM 866/2019 “Per miratimin e Strategjise Kombetare te Mbrojtjes Sociale, 2020-2023 dhe te Planit te veprimit ne zbatim te saj. “
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/866>
- 4- Communicatuon I European Commission, “ On EU Enlargement Policy”, 2022
https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/2022-communication-eu-enlargement-policy_en
- 5- Studim “ Koordinimi I Sigurimeve Shoqerore ne Keshillin e Europes”, Jason Nickless, Helmut Siedl, ISBN 92-871-5393-7
https://www.coe.int/t/dg3/sscssr/Source/SocSec%20coordination%20Short%20Guide_Albanian.pdf

6- Studim “Nje analize e sistemit te Mbrojtjes Sociale ne Shqiperi. Mbulimi, shpenzimet, mjaftueshmeria dhe financimi.”, Botim I Organizates Nderkombetare te Punes, ISBN 9789220347577 (Print) ISBN 9789220347584 (web PDF), 2021,

https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_798637.pdf

7- Strategjia Kombetare “Per zhvillim dhe Integrim, 2022-2030’

https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_538_Draft-Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim-2021--2030-.pdf

8- Bär, M. The pan-European Personal Pension Product: key characteristics and main challenges. *ZVersWiss* **111**, 305–337 (2022)

<https://link.springer.com/article/10.1007/s12297-022-00535-2#Sec2>

9- Studim “Reforma e Programit te Ndhimes Ekonomike ne Shqiperi.Problemet dhe Sfidat” , Botim i Organizates Nderkombetare te Punes,

https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_882825.pdf



Kontakt:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Pyetje?

Dr. Av. Silvana Dode

Faculty of Economy
University of Elbasan

Silvana.Dode@uniel.edu.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES